



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 13. 02. 2020

VENDIM**Nr. 20, datë 13. 02. 2020****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 52, DATË 26. 11. 2019 TË BORDI TË ADMINISTRIMIT UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 288, datë 21. 05. 2018 "Për miratimin e kufirit maksimal, të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike, të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", si dhe shkresës nr. 178 prot, datë 23. 01. 2020, në mbledhjen e datës 13. 02. 2020 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të rimiratojë tarifat e ciklit të dytë të studimit, sipas riorganizimeve me vendime senati, në mbështetje të ndryshimeve të përcjella nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, sipas shkresës nr. 178 prot, datë 23.01.2020 për tabelën bashkëlidhur Vendimit nr. 52, datë 26. 11. 2019 të Bordi të Administrimit.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Bashkëlidhur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. 178 prot, datë 23. 01. 2020.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

